


**MARRËVESHJE PËR THEMELIMIN E
MARRËDHËNIES SË BINJAKËZIMIT MES SHTETEVE
DHE
BASHKËPUNIMIT NË MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
SHTETIT TË IOWA-S (SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS)**

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO DOKUMENTI I PRESIDENTIAK - OFFICE OF THE PRESIDENT	
№. Dokumenti 593	№. Dokumenti C-01
№. Dokumenti -3-	Date 08.07.13
PRISHTINEJA	

Në mes të Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Presidentja e Republikës, Shkëlqësia e Saj, Atifete Jahjaga, dhe shtetit të Iowa-s (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), të përfaqësuar nga Guvernatori, Terry E. Branstad, të cilët në vijim do të njihen me termin Palët, me qëllim të themelimit të marrëdhënieve miqësore, të vetëdijshëm se marrëveshja e tanishme do t'i kontribuojë forcimit të marrëdhënieve të mira në mes të palëve, me qëllim të rritjes së mëtutjeshme të mirëkuptimit dhe miqësisë në mes të popullatave të tyre përkatëse.

ARRIJNË PAJTUESHMËRI QË:

Me këtë dokument, palët pajtohen që të përkufizojnë kornizën e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve të shteteve të motëruara.

NENI 1

Bashkëpunimi në mes të dy palëve do të përqendrohet në:

- a. Promovimin e marrëdhënieve në mes të institucioneve edukative dhe kulturore, duke përfshirë marrëdhëniet në mes të universiteteve dhe qendrave hulumtuese;
- b. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e trajnimeve profesionale dhe të promovimit kulturor, duke përfshirë shfaqjet dhe artet pamore;
- c. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e turizmit dhe sporteve;
- d. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e prodhimit të prodhimeve bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore;
- e. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e procedurave dhe trajnimeve në sistemin e drejtësisë dhe gjyqësisë;
- f. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e zbatimit të ligjit;
- g. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e shëndetësisë;
- h. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- i. Studimin e transportit dhe sistemeve të komunikimit;
- j. Shkëmbimin e informatave dhe përvojave në fushën e veprimtarisë ekonomike;
- k. Zhvillimin e marrëdhënieve në mes të administratave lokale të territoreve përkatëse.

NENI 2

Secila palë do të emërojë një apo më shumë persona përgjegjës për administrimin e kësaj marrëveshjeje. Palët mund të pajtohen që të themelojnë një komitet drejtues ose task force *ad hoc* për të implementuar marrëveshjen apo pjesët e caktuara të marrëveshjes. Komiteti apo task forcat do të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat për të cilat janë pajtuar të dy palët.

NENI 3

Palët do të pajtohen që të krijojnë një protokoll operativ, në mënyrë që të përkufizojnë temat dhe kushtet e veprimtarisë së përgjithshme të fushës së bashkëpunimit. Posaçërisht, palët pajtohen për çështjet si në vijim:

- a. Çdo vit, me radhë, palët do të shkëmbejnë vizita të delegacioneve zyrtare.
- b. Numri i pjesëmarrësve të secilit delegacion zyrtar, duke përfshirë edhe përkthyesin, do të përcaktohet nga të dy palët.
- c. Kostoja e udhëtimit të delegacionit dhe shpenzimet tjera, duke përfshirë edhe fjetjen dhe ushqimin, do të ndahet ndërmjet palëve sipas marrëveshjes së bërë nga palët për secilin delegacion.
- d. Programi i vizitës së delegacioneve përkatëse dhe programi tjetër do të përcaktohet nga palët.

NENI 4

Palët pajtohen që të jenë të përgjegjshme për të lehtësuar zhvillimin e bashkëpunimit duke:

- Mundësuar krijimin e kushteve të favorshme për njëri-tjetrin, në territorin e tyre përkatës, në përputhje me legjislacionin e vendit amë.
- Organizuar ekspozita, panaire dhe aktivitete promovuese.
- Planifikuar dhe ekzekutuar veprimtari shkëmbyese, nga të cilat përfitojnë të dy palët, në fushat e shënuara në Nenin 1, në pajtim me Nenin 2.

NENI 5

Palët do të shkëmbejnë publikimet dhe informatat e nevojshme për zhvillimin e bashkëpunimit.

NENI 6

Palët do të inkurajojnë vendosjen e marrëdhënieve të qyteteve të binjakëzuara ndërmjet qyteteve të Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Iowa-s.

NENI 7

Palët do të inkurajojnë kontaktet ndër-personale në mes të personave dhe institucioneve të përfshira në fushën e artit dhe kulturës, duke promovuar shkëmbime në mes të individëve dhe organizatave publike dhe private.


NENI 8

Marrëveshja e tanishme do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe vlen për pesë vjet. Marrëveshja do të ripërtërihet automatikisht çdo pesë vjet, nëse në atë kohë, asnjëra nga palët nuk tërhiqet nga marrëveshja së paku tre muaj para datës së skadimit të marrëveshjes.

Marrëveshja e bashkëpunimit dhe marrëdhënies së binjakëzimit shtetëror është përpiluar në tri kopje, një në gjuhën shqipe, një në gjuhën angleze dhe një në gjuhën serbe dhe secila prej tyre është e barasvlershme. Në rast të mospërputhjes së ndonjë shprehjeje, versioni në gjuhën angleze do të shërbejë si versioni kontrollues.


Marrëveshja nënshkruhet në Prishtinë, Republika e Kosovës, më datë 7 korrik 2013.

Gubernurit i Shtetit të Iowa-s



Terry E. Branstad

Presidentja e Republikës së Kosovës



Shkëlqësia e Saj. Atifete Jahjaga

SHTOJCË

Organizatrat dhe të emëruarit kontaktues në lidhje me këtë marrëveshje janë:

IOWA SISTER STATES
200 East Grand Avenue
Des Moines, IA 50309-1827

REPUBLIKA E KOSOVËS
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi " Nëna Terezë " p.n
10 000 Prishtinë